

NJOFTIM I RËNDËSISHËM PËR PRINDËRIT NË LIDHJE ME SHËRBIMET E PËRKTHIMIT

Ministria e Arsimit është zotuar që të sigurojë se keni një mundësi të rëndësishme për të marrë pjesë dhe përdorur programet dhe shërbimet që kanë rëndësi të madhe për arsimimin e fëmijës suaj. Ministria e Arsimit ofron shërbime përkthimi që do t'ju ndihmojnë për të komunikuar në mënyrë efektive me shkollën e fëmijës suaj. Informacioni rreth të drejtave tuaja në lidhje me shërbimet e përkthimit gjendet te Deklarata e të Drejtave dhe Përgjegjësive të Prindërve, një kopje e së cilës gjendet në dhomën _____ të kësaj shkolle.

I nxisim prindërit që kanë nevojë për ndihmë me përkthim të kontaktojnë koordinatorin e prindërve të shkollës së tyre. Mund të gjeni më shumë informacion për Zyrën e Përkthimit te faqja e internetit www.nycenet.edu/offices/translation.